

Në bazë të nenit 37 pika 23) të Statutit të Federatës së Çiklizmit të Kosovës, Bordi i FÇK -se, në mbledhjen e vet të mbajtur më 19.11.2022 miratoi këtë:

REGULLORE PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT

Prishtinë 19.11.2022

Dispozita të Përgjithshme

NENI 1

Kjo rregullore përcakton kriteret, kushtet dhe procedurën për shpalljen e laureatëve të vitit në triathlon.

NENI 2

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohet nga Federata e Çiklizmit e Kosovës

NENI 3

1.Federata e Çiklizmit e Kosovës bënë shpalljen e laureatëve të vitit përmes këtyre çmimeve:

1.1. Sportist i vitit;

1.2. Sportistja e vitit;

1.3. Shpresa të Çiklizmit tek meshkujt;

1.4. Shpresa të Çiklizmit tek femrat;

1.5. Trajner i vitit;

1.6. Çmimi special;(ky qmim i ndahet sportistit, trenerit, referit,delegatit, puntori sportiv,hulumtuesi ne fushene triathlonit,gazetar sportiv,mjeku sportiv,për të arritura të veçanta brenda vitit,nëse ka të tillë).

2. Çmimet në paragrafin 1 të këtij Neni ndahen çdo vit dhe ndarja bëhet në një ceremoni solemne të organizuar nga FÇK në muajin shkurt të vitit pasues.

NENI 4

1. Kriter për shpalljen e sportistit, sportistes, shpresës femër,mashkull, trajnerit të çiklizmit të vitit janë rezultatet e arritura në këto gara:

1.1. Lojëra Olimpike;

1.2. Kampionate Botërore;

1.3. Lojëra Evropiane;

- 1.4. Kampionate Evropiane;
- 1.5. Kupa Evropiane ;
- 1.6. Lojëra Mesdhetare;
- 1.7. Kampionate Ballkanike;
- 1.8. Gara nderkombëtare;
- 1.9. Kampionate Kombëtare;
- 2.0. Gara Vendore;
- 2.1. Sportisti/sportistja, trajneri, shpresa femër/mashkull, refer, punëtor sportiv hulumtues ne fushën sportit, gazetar sportiv, mjeku sportiv duhet të jenë qytetar të Kosovës.
- 2.2. Sportisti /sportistja që ka mbushë moshën 14 vjeçare deri në moshën 18 vjeçare konsiderohet shpresë e çiklizmit .
- 2.3. Nëse gjatë vlerësimit të komisionit pikët janë te barabarta në kategori, përparësi ka medalja e nivelit me të lartë, ose nëse nuk ka medalje vlen rezultati më i mirë.

NENI 5

Vendimi për çmimin

1. Bordi i FÇK çdo vit emëron komisionin për shpalljen e laureatëve të vitit.
- 1.2. Komisioni përbëhet nga 3 anëtar ku njëri nga ta bordi e emëron kryetar.
- 1.3. Komisioni pas vlerësimit i rekomandon bordit të FÇK për të marrë vendim.
2. Bordi i FÇK me shumicë te votave vendos ti pranoj ose ti refuzoj rekomandimet e komisionit.
3. Kryetari i FÇK nxjerr vendim për shpalljen e laureatëve të vitit pas miratimit të bordit të FÇK.

NENI 6

Për shpalljen e laureatëve të vitit, komisioni vendos sipas poentimit të përcaktuar në shtojcën e kësaj rregullore.

NENI 7

1. Çmimet vjetore te shpërblimeve përmbajnë një certifikatë të nënshkruar nga kryetari i FÇK.
- 1.1. Certifikata duhet të përmbajë: emblemën e FÇK, emrin dhe mbiemrin e laureatit të çmimit, motivacionin, emrin e çmimit.
- 1.2. Çmimi duhet të shtypet në letër kualitative, me format A3.

NENI 8

1. Bordi përcakton në bazë të mundësive buxhetore nivelin apo llojin e shpërblimit për tu ndarë Laureatëve te Vitit në FÇK.

NENI 9

1. Federata e Çiklizmit e Kosovës për çdo vit emëron komisionin për vlerësimin e performances së laureatëve.
2. Ceremonia e shpalljes se laureatëve te vitit në Çiklizmit gjatë muajit shkurt të vitit pasardhës.

NENI 10

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohet nga FÇK.

NENI 11

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga bordi i FÇK

NENI 12

Poentimi sipas të arriturave në gara sportive

Nr	Emri i garës	Vendi	Pikët
1	Lojërat Olimpike	I	150
2	Lojërat Olimpike	II	140
3	Lojërat Olimpike	III	135
4	Lojërat Olimpike	IV	130
5	Lojërat Olimpike	V	125
6	Lojërat Olimpike	VI	120
7	Lojërat Olimpike	VII	115
8	Lojërat Olimpike	VIII	110
9	Lojërat Olimpike	IX	105

10	Lojërat Olimpike	X	100
11	Kampionati Botëror	I	130
12	Kampionati Botëror	II	125
13	Kampionati Botëror	III	120
14	Kampionati Botëror	IV	115
15	Kampionati Botëror	V	110
16	Kampionati Botëror	VI	105
17	Kampionati Botëror	VII	100
18	Kampionati Botëror	VIII	95
19	Kampionati Botëror	IX	90
20	Kampionati Botëror	X	85
21	Lojëra Evropiane	I	110
22	Lojëra Evropiane	II	105
23	Lojëra Evropiane	III	100
24	Lojëra Evropiane	IV	95
25	Lojëra Evropiane	V	90
26	Lojëra Evropiane	VI	85
27	Lojëra Evropiane	VII	80
28	Lojëra Evropiane	VIII	75
29	Lojëra Evropiane	IX	70
30	Lojëra Evropiane	X	65
31	Kampionate Evropiane	I	105
32	Kampionate Evropiane	II	100
33	Kampionate Evropiane	III	95
34	Kampionate Evropiane	IV	90
35	Kampionate Evropiane	V	85
36	Kampionate Evropiane	VI	80
37	Kampionate Evropiane	VII	75
38	Kampionate Evropiane	VIII	70
39	Kampionate Evropiane	IX	65
40	Kampionate Evropiane	X	60
41	Kupa Evropiane	I	80
42	Kupa Evropiane	II	75
43	Kupa Evropiane	III	70
44	Kupa Evropiane	IV	65
45	Kupa Evropiane	V	60
46	Kupa Evropiane	VI	55
47	Kupa Evropiane	VII	50
48	Kupa Evropiane	VIII	45
49	Kupa Evropiane	IX	40
50	Kupa Evropiane	X	45
51	Lojëra mesdhetare	I	55
52	Lojëra mesdhetare	II	50
53	Lojëra mesdhetare	III	45
54	Lojëra mesdhetare	IV	40

55	Lojëra mesdhetare	V	35
56	Lojëra mesdhetare	VI	30
57	Kampionate Ballkanike	I	50
58	Kampionate Ballkanike	II	45
59	Kampionate Ballkanike	III	40
60	Kampionate Ballkanike	IV	35
61	Kampionate Ballkanike	V	30
62	Kampionate Ballkanike	VI	25
63	Gara ndërkombëtare	I	45
64	Gara ndërkombëtare	II	40
65	Gara ndërkombëtare	III	35
66	Gara ndërkombëtare	IV	30
67	Gara ndërkombëtare	V	25
68	Kampionatet e Kosovës	I	20
69	Kampionatet e Kosovës	II	15
70	Kampionatet e Kosovës	III	10
71	Gara vendore	I	7.50
72	Gara vendore	II	5
73	Gara vendore	III	2.50

Prishtinë më 19.11.2022

**Kryetari i FÇK
AvniNuha**